



Federata Shqiptare e Futbollit

Kodi i Disiplinës Sportive

(I ndryshuar)

Botim zyrtar, 2017

Botim zyrtar 2017

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretar i Përgjithshëm:

Ilir Shulku

Themeluar : 1930

Anëtare në UEFA: 1954

Anëtare në FIFA: 1930

Realizoi botimin: "*Reklama*"

PËRMBAJTJA

TITULLI I Hyrje	9
Neni 1 Objekti	9
Neni 2 Qëllimi i zbatimit: rregulli themelor	9
Neni 3 Qëllimi i zbatimit: individët dhe personat juridikë	10
Neni 4 Qëllimi i zbatimit: koha	10
Neni 5 Përcaktimet	10
Neni 6 Gjinia dhe numri	11
TITULLI II Rregullat Themelore	12
Kreu I Pjesa e Përgjithshme	12
Seksioni 1 Kushtet për dënime	12
Neni 7 Fajësia	12
Neni 8 Aktet e mbetura në tentativë	12
Neni 9 Pjesëmarrja	12
Seksioni 2 Dënime të ndryshme	13
Neni 10 Dënime të përbashkëta për individët dhe personat juridikë	13
Neni 11 Dënime për individët	13
Neni 12 Dënime për personat juridikë, shoqatat, dhe/ose klubet	14
Neni 13 Paralajmërimi	14
Neni 14 Qortimi	14
Neni 15 Gjoha	14
Neni 16 Zmbrapsje e trofeve	15
Neni 17 Masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë)	15
Neni 18 Masë ndëshkimore largimi nga ndeshja (karton i kuq)	16
Neni 19 Pezullimi nga ndeshja	17
Neni 20 Ndalim ose dëbim nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave	17

Neni 21 Ndalim i hyrjes në stadium	18
Neni 22 Ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbolistike	18
Neni 23 Ndalim i kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve	18
Neni 24 Zhvillim i ndeshjes pa spektatorë	18
Neni 25 Zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjëse	18
Neni 26 Ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar	19
Neni 27 Anullimi i rezultatit të një ndeshje	19
Neni 28 Përrjashtimi nga një garë ose kampionat	19
Neni 29 Zbritje në një kategori më të ulët	19
Neni 30 Zbritje e pikëve në klasifikim	19
Neni 31 Humbje e ndeshjes në tavolinë	19
Seksioni 3. Përcaktime të përgjithshme	20
Neni 32 Dënimet e kombinuara	20
Neni 33 Pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimeve	20
Neni 34 Dënimet kohore: përlogaritja e periudhës	21
Neni 35 Centralizimi i dënimeve	21
Seksioni 4. Mbartja dhe anulimi i masave ndëshkimore	
(kartonat) dhe pezullimi nga ndeshja	22
Neni 36 Mbartja e masave ndëshkimore	22
Neni 37 Anullimi i masave ndëshkimore	22
Neni 38 Mbartja e pezullimit nga ndeshja	22
Seksioni 5. Përlogaritja e dënimit	22
Neni 39 Rregulli i përgjithshëm	22
Neni 40 Shkeljet e përsëritura	23
Neni 41 Shkeljet e njëkohshme	23
Seksioni 6. Parashkrimi	23
Neni 42 Parashkrimi për gjykim	23
Neni 43 Fillimi i periudhës së parashkrimit	23
Neni 44 Ndërprerja e periudhës së parashkrimit	24
Neni 45 Periudha e parashkrimit për zbatimin e dënimeve	24
Pjesa e Posaçme	24
Seksioni 7. Shkeljet e Ligjeve të Lojës	24
Neni 46 Shkeljet e lehta	24

Neni 47 Shkeljet e rënda	25
Seksioni 8. Rrëmuajt gjatë ndeshjeve ose garave	26
Neni 48 Sjellja e keqe ndaj kundërshtarëve dhe çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes	26
Neni 49 Sjellja e keqe ndaj zyrtarëve të ndeshjes	27
Neni 50 Grindja	28
Neni 51 Agresorët e paignifikuar	28
SJELLJA E EKIPEVE	29
Neni 52 Nxitja e urrejtjes dhe akteve të dhunës	29
Neni 53 Provokimi i publikut	29
Neni 54 E drejta për të luajtur	29
Neni 55 Braktisja	30
Seksioni 9. Sjelljet ofenduese dhe diskriminuese	30
Neni 56 Sjellja ofenduese dhe fair play	30
Neni 57 Diskriminimi	31
Seksioni 10. Cënimi i lirisë personale	32
Neni 58 Kërcënimet	32
Neni 59 Shtrengimi	32
Seksioni 11. Mashtrimi dhe fallsifikimi	33
Neni 60 Dokumentacioni	33
Seksioni 12. Korrupsioni	33
Neni 61 Korrupsioni	33
Seksioni 13. Dopingu	34
Neni 62 Përkufizimi dhe rregullat	34
Seksioni 14. Dështimi në respektimin e vendimeve	34
Neni 63 Vendimet dhe pagesat	34
Seksioni 15. Përgjegjësitë e personave juridikë, shoqatave dhe klubeve ..	35
Neni 64 Organizimi i ndeshjeve	35
Neni 65 Dështimi në përmbushjen e përgjegjësisë	36
Neni 66 Përgjegjësia për sjelljen e spektatorëve	37
Neni 67 Detyrime të tjera	39
Seksioni 16. Influencimi në mënyrë të paligjshme i rezultatit të ndeshjes ..	39
Neni 68 Trukimi i ndeshjeve	39

TITULLI III Organizimi dhe Procedurat	41
Kreu I Organizimi.....	41
Seksioni 1. Juridiksioni i FSHF-së	41
Neni 69 Rregulli i përgjithshëm	41
Neni 70 Ndeshjet miqësore midis përfaqësueseve	41
Seksioni 2. Autoritetet	42
Neni 71 Arbitri	42
Neni 72 Organet juridike	42
Neni 73 Gjykata e Arbitrazhit për Sportet	42
Neni 74 Komisioni mjekësor pranë FSHF-së	42
Seksioni 3. Komisioni i Disiplinës	42
Neni 75 Juridiksioni i përgjithshëm	42
Neni 76 Juridiksioni i posaçëm	43
Neni 77 Juridiksioni i kryetarit kur merr vendimet i vetëm	43
Seksioni 4. Komisioni i Apelit	44
Neni 78 Juridiksioni	44
Seksioni 5. Rregullat e përbashkëta të organeve juridike	44
Neni 79 Përbërja	44
Neni 80 Mbledhjet	45
Neni 81 Kryetari	45
Neni 82 Sekretaria	46
Neni 83 Pavarësia	46
Neni 84 Papajtueshmëria	46
Neni 85 Heqja dorë	47
Neni 86 Konfidencialiteti	47
Neni 87 Përrjashtimi nga përgjegjësia	48
Kreu II Procedura	49
Seksioni 1. Rregullat e përgjithshme	49
Nënseksioni 1. Afatet	49
Neni 88 Përlllogaritja	49
Neni 89 Përbushja	49
Neni 90 Ndërprerja	50
Neni 91 Shtyrja e afatit	50

Nëseksioni 2. E drejta për t'u dëgjuar	50
Neni 92 Përmbajtja	50
Neni 93 Kufizimi	51
Nëseksioni 3. Provat	51
Neni 94 Llojet e provave	51
Neni 95 Vlerësimi i provave	51
Neni 96 Raportet e zyrtarëve të ndeshjes	52
Neni 97 Barra e provës	52
Nëseksioni 4. Përfaqësimi dhe asistenca	52
Neni 98 Përfaqësimi	52
Nëseksioni 5. Gjuha e përdorur gjatë procedimit	53
Neni 99 Gjuha	53
Nëseksioni 6. Njoftimi i vendimeve	53
Neni 100 Pala e interesuar	53
Neni 101 Forma	53
Nëseksioni 7. Të ndryshme	54
Neni 102 Gabimet	54
Neni 103 Kostot dhe shpenzimet	54
Neni 104 Zbatimi i vendimeve	54
Neni 105 Procedimet e pabazuara	54
Seksioni 2. Komisioni i Disiplinës	55
Nëseksioni 1. Fillimi i procedimit dhe hetimi	55
Neni 106 Fillimi i procedimit	55
Neni 107 Hetimi	55
Neni 108 Bashkëpunimi i palëve	55
Nëseksioni 2. Deklaratat me gojë, shqyrtimi, vendimi	56
Neni 109 Deklaratat me gojë, parimet	56
Neni 110 Deklaratat me gojë, procedurat	56
Neni 111 Shqyrtimi	56
Neni 112 Marrja e vendimit	57
Neni 113 Forma dhe përmbajtja e vendimit	57
Neni 114 Vendimet pa argumentim	58
Seksioni 3. Komisioni i Apelit	58
Neni 115 Vendimet e apelueshme	58

Neni 116 E drejta për të apeluar	59
Neni 117 Afati i apelimit	59
Neni 118 Argumentimi i apelimit	59
Neni 119 Kërkesa e apelit	59
Neni 120 Kostot	60
Neni 121 Efektet e apelimit	60
Neni 122 Radha e procedimit	60
Neni 123 Vazhdimi i procedimit	61
Seksioni 4. Arbitrazhi	61
Neni 124 Arbitrazhi	61
Seksioni 5. Procedurat e veçanta	61
Nëseksioni 1. Masat e përkohshme	61
Neni 125 Rregulli i përgjithshëm	61
Neni 126 Procedura	62
Neni 127 Vendimi	62
Neni 128 Kohëzgjatja.....	62
Neni 129 Apelimi	62
Neni 130 Miratimi i apelimit	63
Nëseksioni 2. Shtrirja e efektit të dënimeve	63
Neni 131 Kërkesa	63
Neni 132 Kushtet	63
Seksioni 6. Rishikimi	64
Neni 133 Rishikimi i vendimeve	64
TITULLI IV Dispozita Përfundimtare	65
Neni 134 Qëllimi i kodit, mangësitë, dhe precedentët	65
Neni 135 Konvertimi i dënimeve	65
Neni 136 Reduktimi i dënimeve me gjobë	66
Neni 137 Zbatimi i kodit	67

TITULLI I HYRJE

Në mbështetje të Nenit 34 të Statutit, dhe Nenit 145, pika 2, 3 të Kodit të Disiplinës së FIFA-s, Komiteti Ekzekutiv i Federatës Shqiptare të Futbollit miraton këtë Kod të Disiplinës Sportive (më poshtë "Kodi").

Neni 1 Objekti

1. Kodi përshkruan shkeljet e përkufizimeve të rregulloreve të FSHF-së, përcakton dënimet që ndërmerren, rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve përgjegjëse për marrjen e vendimeve si dhe rregullon procedurat që ndiqen pranë këtyre organeve.

Neni 2 Qëllimi i zbatimit: rregulli themelor

1. Ky Kod zbatohet për çdo ndeshje dhe garë të organizuar nga FSHF. Përtej këtij qëllimi, ky Kod zbatohet në rastet kur çënohet një zyrtar i ndeshjes, si dhe në përgjithësi, kur shkelen objektivat themelore të FSHF-së, sidomos në lidhje me falsifikimin, korrupsionin dhe dopingun. Gjithashtu zbatohet për çdo rast kur shkelen rregulloret e FSHF-së të cilat nuk janë nën juridiksionin e ndonjë organi tjetër.

Neni 3 Qëllimi i zbatimit: individët dhe personat juridikë

1. Subjekt i këtij kodi janë si më poshtë:
 - a) të gjithë anëtarët e FSHF dhe veçanërisht klubet;
 - b) zyrtarët;
 - c) lojtarët;
 - d) zyrtarët e ndeshjes dhe arbitrat;
 - e) agjentët e liçensuar të lojtarëve ose të ndeshjeve;
 - f) çdo individ i autorizuar nga FSHF, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e ndonjë ndeshje, gare apo veprimtarie të organizuar nga FSHF;
 - g) spektatorët.

Neni 4 Qëllimi i zbatimit: koha

1. Ky Kod zbatohet për fakte të ndodhura pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi. Gjithashtu ky Kod zbatohet për çështje të ndodhura më parë, në rast se përcaktimet e këtij Kodi janë njësoj të favorshme apo më të favorshme për shkelësin përkatës dhe nëse organet gjyquese të FSHF-së janë duke vendosur për këto çështje pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi. Në dallim nga sa më sipër, përcaktimet për procedurat zbatohen menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij Kodi.

Neni 5 Përcaktimet

1. *Pas ndeshjes* - është koha ndërmjet fishkëllimës finale të arbitrit dhe largimit të ekipeve jashtë rrethimit të stadiumit.
2. *Para ndeshjes* - është koha ndërmjet arritjes së ekipeve në rrethimin e stadiumit dhe fishkëllimës së arbitrit për fillimin e ndeshjes.

3. *Ndeshje miqësore* - është ajo ndeshje e organizuar nga FSHF, ndonjë klub apo person midis ekipeve të ndryshme të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme, dhe rezultati ka efekt vetëm për këtë ndeshje apo turne.
4. *Ndeshje zyrtare* - është ajo ndeshje e organizuar nën mbikëqyrjen e FSHF-së, dhe rezultati ka efekt në garat dhe kampionatet e organizuara nga FSHF.
5. *Zyrtar* - është çdokush, duke përjashtuar lojtarët, të cilët kryejnë veprimtari për llogari të ndonjë klubi apo për llogari të FSHF-së, pavarësisht pozicionit të punës, dhe llojit të veprimtarisë që kryen (administrative, sportive, apo ndonjë lloj tjetër) si dhe kohëzgjatjes së veprimtarisë; veçanërisht, menaxherët, trajnerët, dhe personeli mbështetës janë zyrtarë.
6. *Zyrtar ndeshje* - është arbitri, ndihmësat e arbitrit, arbitri i katërt, delegati i ndeshjes, vëzhguesi i arbitrave, personi përgjegjës për sigurinë, dhe çdo person tjetër i cili është caktuar nga FSHF dhe kanë përgjegjësi në lidhje me ndonjë ndeshje.
7. *Rregulloret e FSHF* - janë statutet, rregulloret, udhëzimet dhe qarkoret e FSHF-së, si dhe Ligjet e Lojës të lëshuara nga Bordi i Organizatës Ndërkombëtare të Futbollit.

Neni 6 **Gjinia dhe numri**

1. Përcaktimet të cilat i referohen individëve janë të zbatueshme për të dyja gjinitë. Çdo përcaktim në numrin njëjës zbatohet edhe në numrin shumës, dhe anasjelltas.

TITULLI II RREGULLAT THEMELORE

Kreu I Pjesa e Përgjithshme

SEKSIONI 1 Kushtet për dënime

Neni 7 Fajësia

1. Duke përjashtuar rastet kur parashikohet ndryshe, shkeljet janë të dënueshme pavarësisht se janë kryer në mënyrë të vullnetshme apo nga neglizhenca.
2. Në mënyrë të veçantë, një ndeshje mund të luhet pa spektatorë apo të luhet në një fushë asnjane, ose një stadium mund të pezullohet thjesht për arsye sigurie, pa ndodhur ndonjë shkelje.

Neni 8 Aktet e mbetura në tentativë

1. Aktet e mbetura në tentativë janë të dënueshme.
2. Në rastin e akteve të mbetura në tentativë, organi gjykues mund të vendosë dënimin më të ulët të parashikuar në këtë kod, për aktin e mbetur në tentativë njësoj sikur të kishte ndodhur.

Neni 9 Pjesëmarrja

1. Kushdo që qëllimisht merr pjesë në kryerjen e ndonjë shkelje, si nxitës ose si bashkëpunëtor, është i dënueshëm.

2. Në rastin e pjesëmarrjes si nxitës ose bashkëpunëtor, organi gjykues mund të vendosë dënimin më të ulët të parashikuar në këtë kod, për shkeljen përkatëse të kryer.

SEKSIONI 2.
Dënime të ndryshme

Neni 10 **Dënime të përbashkëta për individët dhe personat juridikë**

1. Individët ashtu edhe personat juridikë janë të dënueshëm me dënimet si më poshtë:
- a) paralajmërim;
 - b) qortim;
 - c) gjobë;
 - d) zmbropsje e trofeve;
 - e) përjashtim nga veprimtaritë, nga garat dhe/ose kampionatet kombëtare.

Neni 11 **Dënime për individët**

1. Dënimet si më poshtë janë të zbatueshme vetëm ndaj individëve:
- a) masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë);
 - b) masë ndëshkimore largimi nga ndeshja (karton i kuq);
 - c) pezullimi nga ndeshja;
 - d) ndalim ose dëbim nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave;
 - e) ndalim i hyrjes në stadium;
 - f) ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbollistike.

Neni 12 Dënime për personat juridikë, shoqatat, dhe/ose klubet

1. Dënimet si më poshtë janë të zbatueshme vetëm ndaj personave juridikë:
 - a) ndalim i kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve;
 - b) zhvillim i ndeshjes pa spektatorë;
 - c) zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjane;
 - d) ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar;
 - e) anulimi i rezultatit të një ndeshje;
 - f) përjashtimi nga një garë ose kampionat;
 - g) humbje e ndeshjes në tavolinë;
 - h) zbritje e pikëve në klasifikim;
 - i) zbritje në një kategori më të ulët.

Neni 13 Paralajmërimi

1. Paralajmërimi është një kujtesë mbi thelbin e një përcaktimi disiplinor e shoqëruar me kërcënimin se në rast të përsëritjes së shkeljes përkatëse do të ndërmerren dënime.

Neni 14 Qortimi

1. Qortimi është një deklaratë dënimi e shkruar, e cila i dërgohet shkelësit në lidhje me shkeljen të cilën ai ka kryer.

Neni 15 Gjoha

1. Një gjobë mund të vendoset në monedhën Lekë Shqiptar (me poshtë: Lekë). Gjohat duhet të paguhet vetëm në Lekë.
2. Kur nuk parashikohet në këtë kod, organi gjykues vendos

për mënyrën dhe afatin e kryerjes së pagesës së gjobave të vendosura.

3. Personat juridikë, klubet ose shoqatat janë përgjegjës në mënyrë solidare ndaj gjobave të vendosura ndaj zyrtarëve ose lojtarëve të tyre. Fakti që një individ është larguar nga personi juridik, nga klubi ose nga shoqata nuk shuan përgjegjësinë solidare për shlyerjen e gjobës.

Neni 16 Zmbrapsje e trofeve

1. Personi të cilit i kërkohet ose i urdhërohet kthimi i trofeve, duhet të kthejë mbrapsht të gjitha përfitimet e marra, veçanërisht shumat e parave të përfituara, si dhe objektet simbolike (medalje, kupa, etj.).

Neni 17 Masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë)

1. Masa ndëshkimore paralajmëruese (kartoni i verdhë) është një paralajmërim që arbitri i bën një lojtari gjatë ndeshjes për të dënuar sjellje jospportive të një natyre jo të rëndë (në përputhje me Ligjet e Lojës).
2. Marrja e dy masave ndëshkimore gjatë të njëjtës ndeshje pason me masë ndëshkimore largimi nga ndeshja (karton i kuq jo i drejtpërdrejtë) dhe, si pasojë, pezullimin automatik nga pjesëmarrja në ndeshjen pasuese të të njëjtës garë ose kampionat të organizuar nga FSHF. Dy masat ndëshkimore paralajmëruese të cilat pasuan me masën ndëshkimore të largimit nga ndeshja shfuqizohen.
3. Nëse një lojtar merr 3 (tre) masa ndëshkimore paralajmëruese në dy ndeshje të ndryshme të të njëjtës garë ose kampionat të organizuar nga FSHF, ky lojtar është i pezulluar automatikisht nga pjesëmarrja në ndeshjen

- pasuese të asaj gare ose kampionati.
4. Nëse një ndeshje e braktisur ose e ndërprerë do të zhvillohet përsëri, atëherë çdo masë ndëshkimore paralajmëruese e lëshuar gjatë kësaj ndeshje do të anulohet. Nëse ndeshja nuk do të zhvillohet përsëri, masat ndëshkimore paralajmëruese të marra nga ekipi i cili ka shkaktuar braktisjen ose ndërprerjen e ndeshjes, do të qëndrojnë në fuqi; nëse të dy ekipet janë shkaktarë për braktisjen ose ndërprerjen e ndeshjes, atëherë të gjitha masat ndëshkimore do të qëndrojnë në fuqi.
 5. Nëse një lojtar është shkaktar për një sjellje jospportive të rëndë siç përcaktohet në Ligjin 12, në Ligjet e Lojës dhe arbitri e largon nga ndeshja (me karton të kuq të drejtpërdrejtë), çdo masë ndëshkimore paralajmëruese që lojtari ka marrë më parë gjatë të njëjtës ndeshje do të qëndrojë në fuqi.

**Neni 18 Masë ndëshkimore largimi nga ndeshja
(karton i kuq)**

1. Masa ndëshkimore e largimit nga ndeshja (kartoni i kuq) është urdhri që arbitri i jep një individ gjatë ndeshjes për t'u larguar nga ndeshja, përfshirë edhe largimin nga stoli i rezervave.
2. Masa ndëshkimore e largimit nga ndeshja merr formën e paraqitjes së kartonit të kuq. Kartoni i kuq konsiderohet i drejtpërdrejtë nëse dënohet një sjellje e rëndë jospportive siç përcaktohet në Ligjin 12, në Ligjet e Lojës; dhe konsiderohet jo i drejtpërdrejtë nëse është rezultat i akumulimit të dy masave ndëshkimore paralajmëruese gjatë të njëjtës ndeshje.
3. Masa ndëshkimore e largimit nga ndeshja pason me pezullimin nga ndeshja pasuese, edhe nëse ndeshja gjatë

të cilës është dhënë masa përkatëse, është braktisur ose është ndërprerë më pas. Komisioni i Disiplinës mund të zgjasë periudhën e pezullimit.

Neni 19 Pezullimi nga ndeshja

1. Pezullimi nga një ndeshje është një ndalim i pjesëmarrjes në një ndeshje të ardhshme apo në një garë ose kampionat si dhe ndalim i qëndrimit në territorin përreth fushës së lojës.
2. Pezullimi vendoset i shprehur në numër ndeshjesh, ditësh, ose muajsh. Nëse nuk është e përcaktuar në dënimin e shkëlqes përkatëse, pezullimi nuk mund të tejkalojë më shumë se 24 (njëzet e katër) ndeshje, ose 24 (njëzet e katër) muaj.
3. Nëse pezullimi do të kryhet i shprehur në numër ndeshjesh, atëherë do të numërohen vetëm ndeshjet e zhvilluara. Nëse një ndeshje është braktisur, ose ndërprerë, ose e përfunduar në tavolinë, pezullimi do të konsiderohet i kryer (numëruar me një ndeshje) vetëm nëse ekipi i lojtarit i cili është ndëshkuar me pezullim, nuk rezulton shkaktar për braktisjen, ndërprerjen apo përfundimin në tavolinë të ndeshjes.
4. Nëse pezullimi është i kombinuar me një gjobë, atëherë pezullimi mund të zgjatet dhe të qëndrojë në fuqi deri kur të paguhet plotësisht vlera e gjobës përkatëse.

Neni 20 Ndalim ose dëbim nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave

1. Ndalimi ose dëbimi nga dhomat e zhveshjes ose nga stoli i rezervave i heq të drejtën një individ për të hyrë në dhomat e zhveshjes si dhe për të qëndruar në territorin përreth fushës së lojës, veçanërisht i ndalohet qëndrimi në stolin e rezervave.

Neni 21 Ndalim i hyrjes në stadium

1. Ndalimi i hyrjes në stadium detyron një individ për të mos hyrë në një ose disa stadione.

Neni 22 Ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbollistike

1. Një individ mund të ndalohej të marrë pjesë në ndonjë veprimtari futbollistike (administrative, sportive, apo tjetër).

Neni 23 Ndalim i kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve

1. Një klub mund të ndalohej të kryejë regjistrim, federim ose transferim të lojtarëve gjatë periudhës që merret masa e ndalimit të kryerjes së transferimit ose federimit të lojtarëve.

Neni 24 Zhvillim i ndeshjes pa spektatorë

1. Detyrimi për të luajtur një ndeshje me dyer të mbyllura i kërkon një personi juridik, një shoqatë ose një klubi për të zhvilluar një ndeshje të caktuar pa spektatorë.

Neni 25 Zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjëse

1. Një person juridik, klub apo shoqatë i dënues të luajë një ndeshje në fushë asnjëse mund ta bëjë këtë vetëm në një fushë që ndodhet të paktën 50 km larg fushës ku ai zhvillon rregullisht ndeshjet në kuadër të veprimtarive të FSHF dhe me miratim të kësaj të fundit.

Neni 26 **Ndalimi i zhvillimit të ndeshjes
në një stadium të caktuar**

1. Ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar i heq të drejtën një personi juridik, një shoqate ose një klubi për të luajtur në një stadium të caktuar.

Neni 27 **Anullimi i rezultatit të një ndeshje**

1. Rezultati i një ndeshje anulohet nëse rezultati i arritur në fushë nuk merret në konsideratë.

Neni 28 **Përrjashtimi nga një garë ose kampionat**

1. Përrjashtimi është heqja e të drejtës një personi juridik, një shoqate ose një klubi për të marrë pjesë në një garë ose kampionat aktual ose të ardhshëm.

Neni 29 **Zbritje në një kategori më të ulët**

1. Një person juridik, një shoqatë ose një klub mund të zbritet në një kategori më të ulët.

Neni 30 **Zbritje e pikëve në klasifikim**

1. Një personi juridik, një shoqatë ose një klubi mund t'i zbriten pikë nga pikët që ka përrftuar në klasifikimin e garës ose kampionatit aktual ose të ardhshëm.

Neni 31 **Humbje e ndeshjes në tavolinë**

1. Ekipet e dënuara me humbje të ndeshjes në tavolinë konsiderohet se e kanë humbur ndeshjen përkatëse me rezultatin 3 - 0 (tre me zero).

2. Nëse diferenca e golave në përfundim të ndeshjes në fjalë është më e madhe se 3 - 0 (tre me zero), atëherë rezultati i arritur në fushën e lojës qëndron në fuqi.

SEKSIONI 3.

Përcaktime të përgjithshme

Neni 32 Dënimet e kombinuara

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe, dënimet e përcaktuara në Kreun I (Pjesa e Përgjithshme) dhe në Kreun II (Pjesa e Posaçme) të këtij Kodi, mund të kombinohen.

Neni 33 Pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimeve

1. Organi gjykues i cili shpall vendimet për dënimet si në vijim: pezullim nga ndeshja (Seksioni 2. Neni 19); ndalim i qëndrimit në dhomën e zhveshjes dhe në stolin e rezervave (Seksioni 2. Neni 20); ndalim i pjesëmarrjes në ndonjë veprimtari futbolistike (Seksioni 2. Neni 22); zhvillim i ndeshjes pa spektatorë (Seksioni 2. Neni 24); zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjënjëse (Seksioni 2. Neni 25); ose, ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në një stadium të caktuar (Seksioni 2. Neni 26); mund të vlerësojë nëse është i mundur pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimit përkatës.
2. Pezullimi i pjesshëm i zbatimit të dënimit është i mundur vetëm nëse perioda e dënimit nuk kalon më shumë se 6 (gjashtë) ndeshje, ose 6 (gjashtë) muaj, dhe nëse rrethanat përkatëse e lejojnë, sidomos sjellja e mëparshme e të dënuarit.
3. Organi gjykues vendos se cila pjesë e dënimit mund të pezullohet. Në çdo rast gjysma e dënimit do të zbatohet detyrimisht.

4. Duke pezulluar pjesërisht zbatimin e dënimit, organi gjykues vendos një periudhë pezullimi me kusht nga 6 (gjashtë) deri në 24 (njëzet e katër) muaj.
5. Nëse i dënuari që përfiton një pezullim të pjesshëm të zbatimit të dënimit, kryen ndonjë shkelje brenda periudhës së pezullimit me kusht të vendosur, pezullimi i pjesshëm anulohet automatikisht dhe fillon zbatimi i menjëhershëm i dënimit të pezulluar; dënimi i pezulluar i shtohet dënimit të ri që vendoset për shkeljen e kryer prej të dënuarit.
6. Ky nen nuk është i zbatueshëm në rastin e verifikimit dhe dënimit për doping.

Neni 34 Dënimet kohore: përlllogaritja e periudhës

1. Periudha e një dënimi kohor mund të ndërpritet përko-hësisht nga periudhat e pushimit gjatë ose në përfundim të sezoneve.

Neni 35 Centralizimi i dënimeve

1. Të dhënat për masat ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë), masat ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq), dhe pezullimi nga ndeshja regjistrohen pranë organeve kompetente të FSHF. Sekretaria e Komisionit të Disiplinës njofton me shkrim ose publikon dënimet e përmendura më sipër. Publikimi i dënimit ka të njëjtin efekt me njoftimin me shkrim.
2. Ky komunikim shërben vetëm si konfirmim: dënimet (kartoni i verdhë, kartoni i kuq, dhe pezullimi nga ndeshja) kanë një efekt të menjëhershëm edhe nëse shkresa e konfirmimit mund të arrijë pranë klubit ose individit të interesuar më vonë.

SEKSIONI 4.

Mbartja dhe anulimi i masave ndëshkimore
(kartonat) dhe pezullimi nga ndeshja

Neni 36 Mbartja e masave ndëshkimore

1. Masat ndëshkimore (karton i verdhë, karton i kuq) të marra gjatë një gare ose kampionati nuk mbarten në një garë ose kampionat tjetër.
2. Gjithsesi, masat ndëshkimore (karton i verdhë, karton i kuq) mbarten nga një raund në një raund tjetër të së njëjtës garë ose kampionat.

Neni 37 Anullimi i masave ndëshkimore

1. Masat ndëshkimore (karton i verdhë, karton i kuq) nuk mund të anulohen në asnjë rast.

Neni 38 Mbartja e pezullimit nga ndeshja

1. Pezullimi nga ndeshja mbartet nga një raund në një tjetër, dhe nga një sezon në një sezon tjetër, të së njëjtës garë ose kampionat.
2. Pezullimi nga ndeshja që ka rezultuar nga marrja e disa masave ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) në ndeshje të ndryshme, nuk mund të mbartet nga një garë ose kampionat në një tjetër.

SEKSIONI 5.

Përlllogaritja e dënimit

Neni 39 Rregulli i përgjithshëm

1. Organi gjykues i cili shpall dënimin përcakton dhe kohëzgjatjen e dënimit.

Neni 40 Shkeljet e përsëritura

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe, organi gjykues mund të rrisë masën e dënimit siç e gjykon të arsyeshme nëse një shkelje është e përsëritur.
2. Përcaktimet në këtë nen janë subjekt i përcaktimeve të veçanta në lidhje me shkeljet e rregullave anti-doping.

Neni 41 Shkeljet e njëkohshme

1. Për shkeljet e kryera në mënyrë të njëkohshme, dënimet përkatëse për çdo shkelje mbliidhen së bashku.

SEKSIONI 6.
Parashkrimi

Neni 42 Parashkrimi për gjykim

1. Shkeljet e kryera gjatë një ndeshje nuk mund të ndiqen nga organet gjyquese nëse kalon më shumë se 2 (dy) vjet. Si rregull të gjitha shkeljet e tjera nuk mund të ndiqen nëse kalon më shumë se 10 (dhjetë) vjet.
2. Shkeljet e rregullave anti-doping nuk mund të ndiqen nëse kalon më shumë se 8 (tetë) vjet.
3. Ndjekja për korrupsion ose trukim të rezultatit nuk është subjekt i parashkrimit.

Neni 43 Fillimi i periudhës së parashkrimit

1. Fillimi i periudhës së parashkrimit llogaritet si më poshtë:
 - a) që nga dita kur shkelësi ka kryer shkeljen përkatëse;
 - b) nëse shkelja është e përsëritur, që nga dita kur është kryer shkelja më e fundit;
 - c) nëse shkelja ka zgjatur për një periudhë të caktuar, që nga dita kur shkelja ka përfunduar.

Neni 44 **Ndërprerja e periudhës së parashkrimit**

1. Periudha e parashkrimit ndërpritet në momentin kur Komisioni i Disiplinës fillon procedurën e ndjekjes së shkeljes përkatëse, përpara skadimit të periudhës së parashkrimit.

Neni 45 **Periudha e parashkrimit
për zbatimin e dënimeve**

1. Periudha e parashkrimit për zbatimin e dënimeve është 5 (pesë) vjet.
2. Periudha e parashkrimit fillon që prej ditës kur hyn në fuqi vendimi i dënimit përkatës.

PJESA E POSAÇME

SEKSIONI 7.
Shkeljet e Ligjeve të Lojës

Neni 46 **Shkeljet e lehta**

1. Ndaj një lojtari merret masë ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) nëse ai kryen një nga shkeljet e përcaktuara më poshtë:
 - a) sjellje josportive;
 - b) kundërshtime me fjalë ose me veprime;
 - c) shkelje e vazhdueshme e Ligjeve të Lojës;
 - d) vonesa në fillimin e lojës;
 - e) mos respektimi i distancës së kërkuar kur riniset loja nga goditje këndi, goditje e lirë, ose rivënie anësore;
 - f) hyrja në fushën e lojës pa lejen e arbitrit; verifikimi i

- këtij rasti dënohet edhe me pezullim nga ndeshja për të paktën 2 (dy) ndeshje;
- g) dalja nga fusha e lojës me paramendim pa lejen e arbitrit; verifikimi i këtij rasti dënohet edhe me pezullim për jo më pak se 4 (katër) ndeshje.

Neni 47 **Shkeljet e rënda**

1. Ndaj një lojtari merret masë ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq) nëse ai kryen një nga shkeljet e përcaktuara më poshtë:
- a) lojë e rëndë duke shkaktuar faull;
 - b) sjellje e dhunshme;
 - c) pështymja e një kundërshtari ose e ndonjë personi tjetër;
 - d) ndalimi i kryerjes së një goli nga ekipi kundërshtar, ose ndalimi i një aksioni të qartë goli të ekipit kundërshtar duke e prekur topin me dorë (ky përcaktim nuk zbatohet për portierin i cili e prek topin brenda zonës së penalltisë);
 - e) ndalimi i një aksioni të qartë goli të ekipit kundërshtar duke kryer një faull të dënueshëm me goditje të lirë ose me penallti, ndërkohë që ekipi kundërshtar drejtohet drejt portës së shkelësit;
 - f) përdorimi i fjalëve të pista, sharjeve dhe gjuhës ofenduese, dhe/ose gjesteve ofenduese;
 - g) marrja e një mase ndëshkimore paralajmëruese (karton i verdhë) të dytë.

Neni 48 Sjellja e keqe ndaj kundërshtarëve dhe çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes

1. Duke përfshirë dhe pezullimin automatik nga ndeshja në përputhje me Seksioni 2. Neni 18 - 3, çdo lojtar i cili ndëshkohet me një masë ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq) i drejtpërdrejtë, do të pezullohet si më poshtë:
 - a) 1 (një) ndeshje për ndalimin e një aksioni të qartë goli të ekipit kundërshtar, veçanërisht duke e prekur topin me dorë në mënyrë të qëllimshme;
 - b) të paktën 1 (një) ndeshje për lojë të rëndë, veçanërisht nëse përdoret dhunë fizike;
 - c) të paktën 6 (gjashtë) muaj për lojë të rëndë, veçanërisht nëse përdoret dhunë fizike, duke shkaktuar dëmtimin e rëndë të lojtarit kundërshtar;
 - d) të paktën 1 (një) ndeshje për sjellje josportive ndaj kundërshtarëve ose personave të tjerë përveç zyrtarëve të ndeshjes;
 - e) të paktën 5 (pesë) ndeshje për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj kundërshtarëve ose çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes;
 - f) të paktën 6 (gjashtë) ndeshje për pështymjen ndaj një kundërshtari ose personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes.
2. Kur personi që ushtron sjellje të keqe ndaj personave të tjerë, përveç zyrtarëve të ndeshjes, është trajner ose zyrtar i personit juridik, shoqatës, ose klubit ku bën pjesë ekipi përkatës, atëherë trajneri ose zyrtari dënohen si më poshtë:

- a) të paktën 3 (tre) ndeshje për sjellje josportive ndaj kundërshtarëve ose personave të tjerë përveç zyrtarëve të ndeshjes;
 - b) të paktën 9 (nëntë) ndeshje për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj kundërshtarëve ose çdo personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes;
 - c) të paktën 12 (dymbëdhjetë) ndeshje për pështymjen ndaj një kundërshtari ose personi tjetër përveç zyrtarëve të ndeshjes.
3. Në çdo rast zbatohet edhe një dënim me gjobë me vlerë nga 100,000 (njëqind mijë) Lekë deri në 300,000 (treqind mijë) Lekë.
4. Pavarësisht se ndaj lojtarit i cili çënon ndonjë person përveç zyrtarëve të ndeshjes, nëpërmjet sjelljes së keqe, nuk merret masë ndëshkimore me largim nga ndeshja (karton i kuq), organet disiplinore kanë të drejtë të zbatojnë dënimet e përcaktuara në paragrafin 1., pikat (a), (b), (c), (d), (e), dhe (f) si dhe dënimin me gjobë në paragrafin 2, të këtij neni.

Neni 49 Sjellja e keqe ndaj zyrtarëve të ndeshjes

1. Një lojtari që dënohet me masën ndëshkimore largim nga ndeshja (karton i kuq) i drejtpërdrejtë, pavarësisht pezullimeve të dhëna në përputhje me Seksioni 2. Neni 18 - 3, do t'i jepen dhe pezullimet si më poshtë:
- a) të paktën 4 (katër) ndeshje për sjellje josportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
 - b) të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
 - c) të paktën 24 (njëzet e katër) muaj për pështymjen ndaj zyrtarëve të ndeshjes.

2. Kur personi që ushtron sjellje të keqe ndaj zyrtarëve të ndeshjes është trajner ose zyrtar i personit juridik, shoqatës, ose klubit ku bën pjesë ekipi përkatës, atëherë trajneri ose zyrtari dënohen si më poshtë:
 - a) të paktën 8 (tetë) ndeshje për sjellje josportive ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
 - b) të paktën 18 (tetëmbëdhjetë) muaj për sulm ose dhunë (goditje me grusht, me bërryl, ose me shkelm) ndaj zyrtarëve të ndeshjes;
 - c) të paktën 24 (njëzet e katër) muaj për pështymjen ndaj zyrtarëve të ndeshjes.
3. Sipas rastit trupa gjykuese mund të aplikojë edhe një masë dënimi me gjobë me vlerë maksimale deri më 1.00.00 (një milion) lekë
4. Pavarësisht se ndaj lojtarit i cili cënon zyrtarët e ndeshjes nëpërmjet sjelljes së keqe, nuk merret masë ndëshkimore me largim nga ndeshja (karton i kuq), organet juridike kanë të drejtë të zbatojnë dënimet e përcaktuara në paragrafin 1, pikat (a), (b), dhe (c), si dhe dënimin me gjobë në paragrafin 2, të këtij neni.
5. Kur si rezultat I shkeljeve të parashikuara në këtë Nen shkaktohet ndërprerja përfundimtare e lojës, personi juridik, personi juridik, shoqata ose klubi ku përkasin shkelësi apo shkelësit do të dënohet me humbjen e ndeshjes në tavoline me rezultatin 3 me 0 në tavoline.

Neni 50 Grindja

1. Përfshirja në një grindje dënohet me një pezullim nga ndeshjet për të paktën 6 (gjashtë) ndeshje, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
2. Kushdo që është përpjekur për të parandaluar një grindje, për të mbrojtur të tjerët ose për të ndarë personat e përfshirë në grindje nuk është subjekt i dënimit.

Neni 51 Agresorët e paignifikuar

1. Nëse, në rastin e grindjeve dhe akteve të dhunës, nuk është i mundur identifikimi i shkelësit ose shkelësve, organi gjykues do të dënojë personin juridik, shoqatën ose

klubin ku përkasin agresorët që kryejnë grindjen ose aktin e dhunës.

Sjellja e ekipeve

Neni 52 Nxitja e urrejtjes dhe akteve të dhunës

1. Një lojtar ose një zyrtar i cili publikisht nxit të tjerët për urrejtje ose akte të dhunës do të dënohet me pezullim nga gara për 12 (dymbëdhjetë) muaj, si dhe me gjobë me vlerë jo më pak se 100,000 (njëqind mijë) Lekë.
2. Në raste të rënda, kur nxitja kryhet duke përdorur median (televizioni, radio, ose shtypi i shkruar) ose nëse kryhet pranë stadiumit gjatë ditës së ndeshjes, vlera e gjobës do të jetë jo më pak se 100.000 (njëqind mijë) deri në 300.000 (treqind mijë) Lekë.
3. Një lojtar ose një zyrtar i cili para, gjatë ose pas ndeshjes shpif ose përhap me dashje fakte të pavërteta për personat juridikë, shoqatat, klubet, zyrtarët e FSHF-së, lojtarët, ose zyrtarët e ndeshjes, dënohet me pezullim nga ndeshjet për një periudhë nga 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 300,000 (treqind mijë) Lekë.

Neni 53 Provokimi i publikut

1. Kushdo që provokon publikun gjatë një ndeshje do të dënohet me pezullim nga gara për 2 (dy) ndeshje, si dhe me gjobë me vlerë jo më pak se 500,000 (pesëqind mijë) Lekë.

Neni 54 E drejta për të luajtur

1. Nëse një lojtar merr pjesë në një ndeshje zyrtare pavarësisht se ai nuk kishte të drejtë të luante (nuk është i federuar, është i pezulluar nga ndeshja, luan si lojtarë i

huaj duke shkelur përcaktimet e vendosura nga Rregullorja e Veprimtarisë Futbollistike etj.), atëherë ekipi i tij do të dënohet me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3 - 0, si dhe me gjobë me vlerë jo më pak se 600,000 (gjashtëqind mijë) Lekë dhe me zbritje të jo më pak se 3 (tre) pikëve nga klasifikimi.

Neni 55 Braktisja

1. Nëse një ekip nuk paraqitet, refuzon të luajë një ndeshje ose të vazhdojë të luajë një ndeshje që ka filluar, atëherë ekipi do të dënohet me humbjen e ndeshjes përkatëse në tavolinë me rezultatin 3 - 0 (tre me zero), zbritjen e jo më pak se 3 (tre) pikëve nga klasifikimi. Kur gara është me sistem eliminimi ai ekip dënohet me mospjesëmarrje në atë garë në sezonin e pasardhës.
2. Në raste të rënda ekipi do të skualifikohet nga vazhdimi i kampionatit apo garës ku merr pjesë, dhe dënohet me zbritje në një kategori më të ulët. Kur gara është me sistem eliminimi ai ekip dënohet me mospjesëmarrje në atë garë për të paktën 2 (dy) sezonet pasardhës.
3. Trajneri, ose ndonjë zyrtar i ekipit i cili nxit braktisjen e ndeshjes nga ekipi përkatës, do të dënohet me pezullim nga veprimtaritë futbollistike për një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muaj, si dhe me gjobë me vlerë jo më pak se 200,000 (dyqind mijë) Lekë.

SEKSIONI 9.

Sjelljet ofenduese dhe diskriminuese

Neni 56 Sjellja ofenduese dhe fair play

1. Kushdo që ofendon një person në çfarëdo lloj mënyre, sidomos duke përdorur gjeste dhe gjuhë ofenduese, ose nëse shkel parimet e fair play, ose kryen sjellje josportive

në çfarëdolloj mënyre, mund të dënohet me përjashtim nga veprimtaritë, nga garat dhe/ose kampionatet kombëtare. Në raste të veçanta dënohet si më poshtë:

- a) trajneri ose lojtari i cili proteston ndaj vendimeve të arbitrit me gjeste ose fjalë ofenduese dënohet me gjobë me vlerë 100,000 (njëqind mijë) Lekë, dhe pezullohet nga ndeshjet për 2 (dy) ndeshje;
- b) në rastin e ofendimeve në grup gjatë zhvillimit të një ndeshje, arbitri i ndeshjes do të zbatojë hapat në vijim:
 - (i) paralajmërim i sektorit përkatës në stadium nga vijnë ofendimet, për të pushuar lëshimin e ofendimeve;
 - (ii) nëse ofendimet vazhdojnë, do të urdhërojë zbrazjen e sektorit përkatës nga spektatorët duke pritur 5 (pesë) minuta;
 - (iii) në rast të mos zbrazjes së sektorit përkatës nga spektatorët, urdhëron ndërprerjen e ndeshjes.
- c) rastet e parashikuara në pikën b dënohen me humbje të ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3-0 (tre me zero) në dëm të personit juridik, shoqatës ose klubit vendas.

Neni 57

Diskriminimi

1.

- a) Kushdo që ofendon dinjitetin e një personi apo grupi personash nëpërmjet fjalëve ose veprimeve përçmuese, diskriminuese ose denigruese në lidhje me racën, ngjyrën, gjuhën, besimin fetar, ose origjinën do të pezullohet për të paktën 5 (pesë) ndeshje. Gjithashtu, do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 100.000 (njëqind mijë) Lekë.
- b) Kur persona të ndryshëm (zyrtarë ose lojtarë) të të njëjtit klub, person juridik, ose shoqatë shkëlin njëko-

- hësisht paragrafin 1.(a) të këtij neni, ose ekzistojnë rrethana rënduese, ekipi në fjalë do të dënohet me zbritje të 3 (tre) pikëve në klasifikim, dhe në rast të përsëritjes së kësaj shkelje dënohet me zbritje të 6 (gjashtë) pikëve, dhe në rast të përsëritjes së tretë të kësaj shkelje ekipi do të zbritet në një kategori më të ulët, ose për veprimtaritë me sistem eliminimi, skualifikim nga gara dhe ndalim i pjesëmarrjes në të njëjtën garë sezonin pasardhës.
- c) Shkeljet me rrethana rënduese ose shkeljet e përsëritura dënohen edhe me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3 - 0 (tre me zero), dhe zbritjen e 3 (tre) pikëve nga klasifikimi.

SEKSIONI 10.

Cënimi i lirisë personale

Neni 58 **Kërcënimet**

1. Kushdo që kërcënon një zyrtar ndeshje do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,000,000 (një milion) Lekë.
2. Nëse kërcënimi kryhet gjatë zhvillimit të një ndeshje, ekipi ku bën pjesë personi që kryen kërcënimin ndaj zyrtarëve të ndeshjes, do të dënohet me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3 - 0 (tre me zero), dhe zbritjen e 3 (tre) pikëve nga klasifikimi.

Neni 59 **Shtrëngimi**

1. Kushdo që përdor dhunë ose kërcënime për të ndikuar ose shtrënguar një zyrtar ndeshje, që ky i fundit të kryejë veprime të caktuara ose dhe thjesht moslejimin e zyrtarit të ndeshjes për të vepruar lirisht, do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë.

SEKSIONI 11.
Mashtrimi dhe fallsifikimi

Neni 60 Dokumentacioni

1. Kushdo që fallsifikon dokumentacionin gjatë veprimtarive futbollistike do të dënohet me pezullim nga ndeshjet për të paktën 12 (dymbëdhjetë) muaj.
2. Gjithashtu në çdo rast, shkelësi do të dënohet me gjobë me një vlerë jo më pak se 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

SEKSIONI 12.
Korrupsioni

Neni 61 Korrupsioni

1. Kushdo që ofron, premtan, ose dhuron një favor ndaj një organi ose zyrtari të FSHF-së, një zyrtari të ndeshjes, një lojtari ose një zyrtari, për llogari të vetë apo për llogari të një pale të tretë duke u përpjekur për të nxitur personin përkatës të shkelë rregulloret e FSHF-së, do të dënohet si në vijim:
 - a) me gjobë me një vlerë jo më pak se 1,000,000 (një milion) Lekë;
 - b) me përjashtim nga veprimtaritë futbollistike për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet;
 - c) me përjashtim për mos hyrje në ndonjë stadium për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet;
 - d) dënimet këtu më sipër vendosen së bashku.
2. Korrupsioni pasiv (kërkesa, marrja e premtimeve ose pranimi i favoreve të pajustificuara) do të dënohet njësoj si në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Në rrethana rënduese, ose në rast të përsëritjes, dënimi i përcaktuar në paragrafin 1. (b) mund të shpallet për një periudhë përgjithmonë.

4. Në çdo rast, organi gjykues urdhëron konfiskimin e vlerave të shfrytëzuara për kryerjen e shkeljes. Vlerat duhet të depozitohen pranë FSHF-së, dhe do të përdoren për programe zhvillimi në sportin e futbollit.

SEKSIONI 13.

Doping

Neni 62 Përkufizimi dhe rregullat

1. Doping është i ndaluar.
2. Lojtari që nuk pranon të kryejë kontrollin anti-doping, pezullohet nga ndeshjet për një periudhë nga 3 (tre) deri në 6 (gjashtë) muaj, si dhe dënohet me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

SEKSIONI 14.

Dështimi në respektimin e vendimeve

Neni 63 Vendimet dhe pagesat

1. Kushdo që dështon për të paguar një person (si një lojtar, një trajner ose një klub) ose FSHF-në për ndonjë shumë parash plotësisht ose pjesërisht, edhe pse është urdhëruar nga ndonjë organ ose komision i FSHF-së (vendime financiare), ose kushdo që dështon në përmbushjen e ndonjë vendimi tjetër (vendime jofinanciare) të lëshuar nga ndonjë organ ose komision i FSHF-së:
 - a) do t'i jepet një afat paralajmërues jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga organi gjykues i FSHF-së, për të paguar detyrimet për vendimet financiare, dhe për të përmbushur vendimin jo-financiar;
 - b) lojtarët të cilët me vendim të organeve gjyqësive të FSHF kanë detyrime financiare të papaguara nuk do të aktivizohen deri në shlyerjen e detyrimeve.

- c) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit paralajmërues në rast se dështojnë në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jo-financiar, atëherë klubi përkatës **do të dënohet me zbritje të 3 (tre) pikëve nga klasifikimi, dhe do t'i jepet një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga organi gjykues i FSHF-së, për të paguar detyrimet për vendimet financiare, dhe për të përmbushur vendimin jo-financiar.**
- d) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit paralajmërues prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, në rast dështimi në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jo-financiar, atëherë klubi përkatës do të dënohet me zbritje të 3 (tre) pikëve nga klasifikimi duke dhënë një afat përfundimtar prej 10 (dhjetë) ditësh nga organi gjykues i FSHF-së për të paguar detyrimet për vendimet financiare, dhe për të përmbushur vendimin jo-financiar.
- e) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit përfundimtar në rast se dështojnë në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jo-financiar, atëherë klubi përkatës do të dënohet me zbritje në një kategori më të ulët.

SEKSIONI 15.

Përgjegjësitë e personave juridikë, shoqatave dhe klubeve

Neni 64 Organizimi i ndeshjeve

1. Personat juridikë, shoqatat dhe klubet që organizojnë ndeshjet zyrtare si fusha pritëse duhet të përmbushin përcaktimet si më poshtë:
 - a) të vlerësojnë nivelin e riskut për çdo ndeshje që

- zhvillohet në fushën e administruar prej tyre dhe të njoftojnë menjëherë organet e FSHF për ndeshjet të cilat paraqesin nivel të lartë të riskut;
- b) të përmbushin dhe të zbatojnë rregullat e sigurisë (rregullat përkatëse të FSHF-së, dhe/ose legjislationin në fuqi) dhe të ndërmarrin hapat e nevojshëm për garantimin e sigurisë përpara, gjatë dhe pas ndeshjes, si dhe nëse ndodhin incidente të mundshme;
 - c) të garantojnë sigurinë e zyrtarëve të ndeshjes, lojtarëve dhe zyrtarëve të klubit kundërshtar gjatë qëndrimit të tyre kur zhvillohen ndeshje në fushën e tyre;
 - d) të mbajnë kontakt dhe të bashkëpunojnë me autoritetet vendore (pushtetin vendor, policinë e rendit) në mënyrë efektive;
 - e) të garantojnë zbatimin e ligjit dhe të mbajnë rregullin dhe qetësinë në stadium dhe rrethinat e stadiumit dhe ndeshjet të zhvillohen në rregull.

Neni 65**Dështimi në përmbushjen e përgjegjësive**

1. Personat juridikë, shoqatat dhe klubet që dështojnë në përmbushjen e detyrimeve dhe përgjegjësive të tyre në përputhje me Neni 65 do të dënohen me gjobë.
2. Në rastet e shkeljeve të rënda mund të ndërmerren dënime të tjera, si zhvillim i ndeshjes pa spektatorë, zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjëse, ndalimi i zhvillimit të ndeshjes në stadiumin përkatës, anulimi i rezultatit të ndeshjes, përjashtimi nga një garë ose kampionat, dhe/ose humbje e ndeshjes në tavolinë.
3. Personat juridikë, shoqatat dhe klubet që organizojnë ndeshjet zyrtare si fusha pritëse do të dënohen si më poshtë:

- a) në rastin e hyrjes brenda pjesës së rrethuar të fushës së lojës të ndonjë personi, pa shkaktuar akte të dhunës ose ndërprerje të lojës, ekipi përgjegjës për sigurinë në stadium do të penalizohet me zhvillimin e 1 (një) ndeshje pa spektatorë.
 - b) në rastin e hyrjes brenda pjesës së rrethuar të fushës së lojës të ndonjë personi, duke shkaktuar akte të dhunës ndaj lojtarëve në fushë, dhe/ose zyrtarëve të ndeshjes, dhe/ose ndërprerje të lojës, ekipi përgjegjës për sigurinë në stadium, ose ekipi përgjegjës për aktet e kryera, do të penalizohet me humbjen e ndeshjes në tavolinë me rezultatin 3-0 si dhe zhvillimin e të paktën 4 ndeshjeve pa spektatorë.
4. Organi gjykues ka të drejtë të vendos dënime edhe nëse nuk është verifikuar ndonjë shkelje e përcaktimeve këtu në këtë kod, por thjesht për çështje të mospërbushjes së standardeve të sigurisë.

Neni 66 Përgjegjësia për sjelljen e spektatorëve

1. Personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet mikpritëse të ndeshjeve janë përgjegjëse për sjelljen e gabuar të spektatorëve, pavarësisht se faji mund të kryhet me vetëdije apo pa vetëdije, dhe si rrjedhim dënohen me gjobë në çdo rast. Mund të vendosen edhe dënime të tjera në rastin e verifikimit të ngjarjeve të rënda.
2. Personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet mike janë përgjegjëse për sjelljen e gabuar të grupit të tyre të spektatorëve, pavarësisht se faji mund të kryhet me vetëdije apo pa vetëdije, dhe si rrjedhim dënohen me gjobë në çdo rast. Mund të vendosen edhe dënime të tjera në rastin e verifikimit të ngjarjeve të rënda. Nëse nuk provohet e kundërta, tifozët të cilët qëndrojnë në sektorin e miqve në stadium konsiderohen si tifozë ose mbështetës të ekipit mik (personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet mike).

3. Sjellje e gabuar përfshin akte të dhunës ndaj personave ose objekteve, lëshimi ose hedhja e mjeteve ndezëse, përdorimi i dritave laser, përdorimi i dronëve, hedhja e fishekzjarrëve, paraqitja e parullave politike ose ofenduese të çfarëdolloj forme, shprehja e fjalëve ose zhurmave/tingujve ofenduese, ose hyrja në fushën e lojës. Në rastin e verifikimit të shkeljeve si më sipër ndaj personave juridikë, shoqatave dhe/ose klubeve ku konsiderohen si mbështetës spektatorët kundërvajtës, do të jepen dënimet si më poshtë:
- a) në rastin e hedhjes së mjeteve ndezëse, hedhjes së fishekzjarrëve, hedhjes së gurëve ose sendeve të tjera brenda rrethimit të fushës së lojës, pa shkaktuar akte të dhunës ose ndërprerje të lojës, sanksionohen me dënimin e fushës për të paktën 1 (një) ndeshje pa spektatorë;
 - b) në rastin e hedhjes së mjeteve ndezëse, hedhjes së fishekzjarrëve, hedhjes së gurëve ose sendeve të tjera brenda rrethimit të fushës së lojës, duke shkaktuar akte të dhunës ose ndërprerje të përkohshme të lojës, sanksionohen me ndalimin e zhvillimit të ndeshjes në stadiumin përkatës për jo më pak se 4 (katër) ndeshje pa spektatorë;
 - c) në rastin e hedhjes së mjeteve ndezëse, hedhjes së fishekzjarrëve, hedhjes së gurëve ose sendeve të tjera brenda rrethimit të fushës së lojës, duke shkaktuar ndërprerje përfundimtare të lojës, sanksionohen me ndalimin e zhvillimit të ndeshjes në stadiumin përkatës për jo më pak se 6 (gjashtë) ndeshje.
 - d) në rastin e hedhjes së mjeteve ndezëse, hedhjes së fishekzjarrëve, hedhjes së gurëve ose sendeve të tjera brenda rrethimit të fushës së lojës, duke shkaktuar akte të dhunës ndaj zyrtarëve të ndeshjes dhe ndërprerje të përkohshme të lojës, sanksionohen me ndalimin e zhvillimit të ndeshjes në sta-

- diumin përkatës për jo më pak se 8 (tetë) ndeshje.
- e) (vetëm për personat juridikë, shoqatat ose klubet:) me skadimin e afatit përfundimtar në rast se dështojnë në përmbushjen e detyrimeve financiare ose të përmbushjes së vendimit jo-financiar, atëherë klubi përkatës do të dënohet me zbritje në një kategori më të ulët.

Neni 67 **Detyrime të tjera**

1. Personat juridikë, shoqatat dhe/ose klubet duhet:
- a) të garantojnë se nuk do të përfshihet në menaxhimin e klubit, asnjë person që mund të jetë në ndjekje ligjore për shkak të përfshirjes në çështje dopingu, të korrupsionit, ose fallsifikimit, ose asnjë person i cili është shpallur fajtor për çështje penale brenda 5 (pesë) viteve të fundit.

SEKSIONI 16.

Influencimi në mënyrë të paligjshme i rezultatit të ndeshjes

Neni 68 **Trukimi i ndeshjeve**

1. Kushdo që komploton për influencimin e rezultatit të një ndeshje në kundërshtim me etikën sportive do të dënohet me pezullim nga ndeshjet për një periudhë prej 6 (gjashtë) muaj, si dhe me gjobë me një vlerë nga 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë deri në 3,000,000 (tre milion) Lekë. Me verifikimin e rasteve serioze, ose rasteve të bashkëpunimit në mënyrë të organizuar, shkelësit do të dënohen edhe me përjashtim përjetë nga veprimtaritë

futbollistike.

2. Në rastin e verifikimit të pjesëmarrjes së një lojtari ose zyrtari në influencimin e rezultatit të ndeshjes në përputhje me paragrafin 1. të këtij neni, personi juridik, shoqata ose klubi ku bën pjesë lojtari ose zyrtari përkatës do të dënohet me gjobë me një vlerë prej 2,000,000 (dy milion) Lekë. Me verifikimin e rasteve serioze, ose rasteve të bashkëpunimit në mënyrë të organizuar, personi juridik, shoqata ose klubi përkatës do të dënohet edhe me zbritje të 12 (dymbëdhjetë) pikëve, përjashtim nga gara ose kampionati, ose zbritje në një kategori më të ulët.

TITULLI III ORGANIZIMI DHE PROCEDURAT

Kreu I Organizimi

SEKSIONI 1. Juridiksioni i FSHF-së

Neni 69 Rregulli i përgjithshëm

1. Të gjitha ndeshjet zyrtare ose miqësore që organizohen nga FSHF, janë nën juridiksionin e organeve gjyquese të FSHF-së. Dënimet të cilat vendosen nga këto organe kanë efekt në të gjithë botën.
2. FSHF do të njoftojë organet e FIFA-s në rastin e verifikimit të shkeljeve të rënda të objektivave statutore të FIFA-s.
3. FIFA mund të dënojë këdo që shkel objektivat statutore të FIFA-s.

Neni 70 Ndeshjet miqësore midis përfaqësueseve

1. Çdo veprim disiplinor që ndërmerret gjatë një ndeshje miqësore ndërmjet ekipit përfaqësues të vendit tonë dhe ekipit përfaqësues të ndonjë federate tjetër, ndaj lojtarëve të ekipit përfaqësues të vendit tonë, do të dënohet nga organet gjyquese të FSHF-së.
2. FSHF do të njoftojë FIFA-n për dënimet e vendosura në çdo rast.
3. FIFA ka të drejtë të verifikojë përputhshmërinë e dënimeve të vendosura me përcaktimet e Kodit të Disiplinës, të FIFA-s, edicioni 2009.

SEKSIONI 2.
Autoritetet

Neni 71 Arbitri

1. Gjatë ndeshjeve, veprimet disiplinore ndërmerren nga arbitri.
2. Vendimet e marra janë përfundimtare.

Neni 72 Organet juridike

1. Organet juridike të FSHF-së janë Komisioni i Disiplinës, Komisioni i Apelit dhe Dhoma Kombëtare e Zgjidhjes së Konfliktëve.

Neni 73 Gjykata e Arbitrazhit për Sportet

1. Vendimet e Komisionit të Apelit mund të apelojnë tek Gjykata e Arbitrazhit për Sportet (CAS) në përputhje me Nenin 128 të këtij Kodi.

Neni 74 Komisioni mjekësor pranë FSHF-së

1. Në përputhje me Rregulloret Anti-Doping të FIFA-s, Komisioni Mjekësor pranë FSHF-së kryen testimet për doping, kryen analizat e kampioneve dhe kontrollon certifikatat mjekësore.

SEKSIONI 3.
Komisioni i Disiplinës

Neni 75 Juridiksioni i përgjithshëm

1. Komisioni i Disiplinës i FSHF-së është i autorizuar të

dënojnë çdo shkelje të rregulloreve të FSHF-së të cilat nuk janë nën juridiksionin e organeve të tjera të FSHF-së.

Neni 76 **Juridiksioni i posaçëm**

1. Komisioni i Disiplinës është përgjegjës për:
 - a) të dënojnë shkelje të rënda të cilat nuk janë vënë re nga zyrtarët e ndeshjes;
 - b) të zgjasë periudhën e pezullimit nga ndeshja e cila fillon automatikisht pas marrjes së masës ndëshkimore me largim nga ndeshja (karton i kuq);
 - c) të ndërmarë dhe të shpallë dënime të tjera në përputhje me këtë kod.

Neni 77 **Juridiksioni i kryetarit kur merr vendimet i vetëm**

1. Kryetari i Komisionit të Disiplinës mund të marrë i vetëm, vendimet si më poshtë:
 - a) pezullimin e ndonjë personi për një periudhë deri në 3 (tre) ndeshje, ose deri në 2 (dy) muaj;
 - b) të vendosë një dënim me gjobë për shkelje për të cilat vlera maksimale e gjobës nuk kalon shumë prej 300,000 (treqind mijë) Lekë;
2. Kryetari i Komisionit të Disiplinës në çdo rast mund të vendosë që vendimet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, të merren nga Komisioni i Disiplinës me të paktën tre anëtarë.

SEKSIONI 4.
Komisioni i Apelit

Neni 78 **Juridiksioni**

1. Komisioni i Apelit është përgjegjës për të vendosur ndaj apelimeve kundër vendimeve të marra nga Komisioni i Disiplinës të cilat nuk konsiderohen si përfundimtare nga rregulloret e FSHF-së, ose i referohen juridiksionit të ndonjë organi tjetër.

SEKSIONI 5.
Rregullat e përbashkëta të organeve juridike

Neni 79 **Përbërja**

1. Komiteti Ekzekutiv emëron anëtarët e Komisionit të Disiplinës dhe të Komisionit të Apelit me një mandat prej 4 (katër) vjetësh. Bazuar në statutin e FSHF anëtarët për Komisionin e Disiplinës janë 10, ndërsa për Komisionin e Apelit 5 anëtarë.
2. Komiteti Ekzekutiv emëron Presidentin për secilin nga komisionet, duke e zgjedhur ndërmjet anëtarëve të emëruar.
3. Secili nga komisionet zhvillon një mbledhje për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve zëvendësues të presidenteve, duke përzgjedhur me votim të thjeshtë midis anëtarëve të cilët janë pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse, me një mandat prej 4 (katër) vjetësh. Kandidatët nuk kanë të drejtë të votojnë.
4. Presidenti, zv. Presidenti dhe të paktën 5 anëtarë të

Komisionit të Disiplinës duhet të jenë me formim dhe kualifikim në fushën juridike.

5. Presidenti, zv. Presidenti dhe anëtarët e tjerë të Komisionit të Apelit duhet të jenë me formim dhe kualifikim në fushën juridike.

Neni 80 **Mbledhjet**

1. Mbledhjet e komisioneve konsiderohen të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë të paktën tre anëtarë të komisioneve përkatëse.
2. Me urdhër të kryetarit, sekretaria e komisioneve thërret anëtarët që duhet të marrin pjesë në mbledhjet përkatëse të komisioneve.
3. Çdo çështje shqyrtohet nga një trup gjykues i përbërë nga 3 anëtarë, të cilët janë emëruar sipas rregullave nga Presidenti i Komisionit të Disiplinës ose Apelit. Kryetari i çdo trupi gjykues që shqyrton një çështje të vetme emërohet nga Presidenti i Komisionit të Disiplinës dhe në çdo rast duhet të jetë jurist. Në rastet kur Presidenti është anëtar i trupit gjykues, ai ushtron kompetencat e kryetarit të trupit gjykues.
4. Mbledhja drejtohet vetëm nga kryetari ose një anëtar që zotëron formim dhe kualifikim në fushën juridike.

Neni 81 **Kryetari**

1. Kryetari i trupës së gjykimit drejton mbledhjet dhe shpall vendimet për të cilat i jep fuqi ky Kod.
2. Nëse kryetari e ka të pamundur pjesëmarrjen në ndonjë mbledhje atëherë, një anëtar zëvendësues i kryetarit e zëvendëson atë. Nëse edhe anëtari zëvendësues i kryetarit nuk mund të marrë pjesë në mbledhje atëherë, kryetari zëvendësohet nga anëtari më i vjetër në detyrë i cili

zotëron formimin dhe kualifikimin përkatës në fushën juridike.

Neni 82 Sekretaria

1. Sekretariati i përgjithshëm i FSHF-së u siguron organeve gjyquese një sekretari dhe personelin e nevojshëm pranë ambienteve të FSHF-së.
2. Sekretariati i përgjithshëm i FSHF-së emëron sekretarinë.
3. Sekretaria ka në përgjegjësi punën administrative, shkruan proces-verbalin e mbledhjeve si dhe shkruan vendimet e marra nga organet juridike përkatëse.
4. Sekretaria kujdeset dhe mban përgjegjësi për arkivimin e dokumentacionit. Vendimet e marra dhe dosja përkatëse (kërkesat, provat, materialet, etj.) e cila është pjesë përbërëse e vendimit, duhet të arkivohet dhe të ruhet për të paktën 10 (dhjetë) vjet.

Neni 83 Pavarësia

1. Organet gjyquese të FSHF-së i marrin vendimet në mënyrë të pavarur; dhe veçanërisht, ato nuk mund të marrin udhëzime nga ndonjë organ tjetër i FSHF-së.
2. Asnjë anëtar i ndonjë organi tjetër të FSHF-së nuk mund të qëndrojë në dhomën e mbledhjes gjatë shqyrtimit të çështjeve, përveç rastit kur ky anëtar është thirrur posaçërisht për t'u dëgjuar nga organi gjyques përkatës.

Neni 84 Papajtueshmëria

1. Anëtarët e organeve gjyquese nuk mund të bëjnë pjesë as në Komitetin Ekzekutiv apo në ndonjë organ tjetër të FSHF-së.

Neni 85 **Heqja dorë**

1. Anëtarët e organeve gjyquese të FSHF-së mund të refuzojnë të marrin pjesë në ndonjë mbledhje ose shqyrtim në lidhje me ndonjë çështje kur ekzistojnë rrethana të forta për të vënë në dyshim paanshmërinë e tyre.
2. Përveç të tjerave, kjo zbatohet në rastet si më poshtë:
 - a) nëse anëtari në fjalë ka një interes të drejtpërdrejtë në rezultatin e shqyrtimit të çështjes;
 - b) nëse ka lidhje me ndonjë nga palët në shqyrtim;
 - c) nëse ai është marrë më parë me të njëjtën çështje në rrethana të tjera.
3. Anëtarët të cilët refuzojnë të marrin pjesë në ndonjë mbledhje për arsyet e përmendura më sipër duhet të njoftojnë menjëherë kryetarin e komisionit përkatës.
4. Palët e përfshira në shqyrtim kanë të drejtë të ngrenë kundërshtime ndaj pjesëmarrjes në mbledhjen komisionit të ndonjë anëtari që ata mendojnë se ka lidhje interesi. Kryetari i komisionit vendos në lidhje me këtë kundërshtim.
5. Procedurat ku është përfshirë ndonjë anëtar i cili është urdhëruar nga kryetari për të mos marrë pjesë, do të konsiderohen të pavlefshme.

Neni 86 **Konfidencialiteti**

1. Anëtarët e organeve gjyquese duhet të garantojnë se çdo informacion që vjen në dijeninë e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve duhet të mbetet konfidencial (faktet dhe provat e çështjeve, përmbajtja e diskutimeve, dhe marrja e vendimeve).
2. Vetëm përmbajtja e vendimeve të cilat i janë dërguar me postë palës së interesuar mund të bëhet publike.

Neni 87 **Përgjegjësia nga përgjegjësia**

1. Përveç rasteve të fajit të rëndë, asnjë nga anëtarët e organeve gjyqësive të FSHF-së dhe as sekretaria e organeve gjyqësive, nuk mund të bëhen përgjegjës për veprimet ose mangësitë në zbatimin e procedurave disiplinore.

KREU II PROCEDURA

SEKSIONI 1. Rregullat e përgjithshme

NËNSEKSIONI 1. Afatet

Neni 88 Përlllogaritja

1. Afatet që duhet të zbatojnë personat juridikë, shoqatat, klubet ose individët fillojnë ditën kur ato marrin dokumentin përkatës.
2. Nëse dita e fundit e afatit përkatës përkon në ndonjë festë zyrtare, atëherë afati skadon menjëherë ditën e parë të punës që nuk është festë zyrtare.

Neni 89 Përmbushja

1. Afati konsiderohet i përmbushur vetëm në rast se detyrimi ose veprimi i kërkuar është kryer përpara skadimit të afatit.
2. Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi ose nëpërmjet postës jo më vonë se orari zyrtar në ditën e fundit të afatit të caktuar.
3. Nëse dokumentacioni dërgohet me faks, afati konsiderohet i përmbushur nëse dokumenti origjinal dorëzohet pranë organit përkatës të FSHF-së jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e dërgimit me faks.
4. Palët nuk janë të lejuara të përmbushin afatet duke komunikuar nëpërmjet postës elektronike.
5. Në rastin e kryerjes së pagesave për veprimet e kryera

pranë organeve juridike, afati konsiderohet i përmbushur nëse pagesa përkatëse është bërë efektive në llogarinë e FSHF-së jo më vonë se mesnata e ditës së fundit të afatit përkatës.

Neni 90 **Ndërprerja**

1. Afatet ndërpriten:
 - a) vetëm në ditët festive zyrtare.
2. Në rrethana të caktuara mund të vendosen periudha të tjera të ndërprerjes së afateve.

Neni 91 **Shtyrja e afatit**

1. Kryetari organit juridik mund të shtyjë afatin që ai ka vendosur, pas kërkesës së palës së interesuar. Megjithatë, afatet e përcaktuara në këtë kod nuk mund të shtyhen.
2. Një afat nuk mund të shtyhet më shumë se dy herë, dhe shtyrja për herë të dytë mund të kryhet vetëm për rrethana të veçanta.
3. Nëse kryetari i organit juridik refuzon shtyrjen e afatit, palës së interesuar i jepet automatikisht dhe 2 (dy) ditë kohë për të përmbushur afatin.

NËNSEKSIONI 2.
E drejta për t'u dëgjuar

Neni 92 **Përmbajtja**

1. Palët do të dëgjohen përpara se të merret ndonjë vendim.
2. Në veçanti ato mund:
 - a) të paraqesin argumentet e tyre me fakte dhe mbështetje ligjore;
 - b) të kërkojnë sigurimin e provave;

- c) të përfshihen gjatë sigurimit të provave;
- d) të pretendojnë marrjen e një vendimi të arsyeshëm.

Neni 93 Kufizimi

- 1. E drejta për t'u dëgjuar mund të kufizohet në rrethana të veçanta, sidomos kur shqyrtohen çështje konfidenciale ose në rastin e mbrojtjes së procedurave të hetimit.

NËNSEKSIONI 3.
Provat

Neni 94 Llojet e provave

- 1. Organi juridik administron çdo lloj prove.
- 2. Provat që çënojnë dinjitetin individual ose nuk shërbejnë për të argumentuar fakte që kanë lidhje me shqyrtimin përkatës, do të refuzohen.
- 3. Në veçanti, provat në vijim janë të pranueshme: raportet nga arbitrat, ndihmës arbitrat, delegatët dhe vëzhguesit e arbitrave, deklaratat e palëve dhe dëshmitarëve, provat materiale, opinionet e ekspertëve dhe regjistrimet audio dhe video.

Neni 95 Vlerësimi i provave

- 1. Organet juridike kanë të drejtë ekskluzive në trajtimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e provave të siguruara.
- 2. Në veçanti ato mund të marrin në konsideratë qëndrimet e palëve gjatë procedimit, sidomos për mënyrën se si bashkëpunojnë palët me organet juridike dhe sekretarinë.
- 3. Organet juridike gjykojnë mbështetur në bindjet e tyre personale.

Neni 96 Raportet e zyrtarëve të ndeshjes

1. Faktet që përmbahen në raportet e zyrtarëve të ndeshjes konsiderohen të sakta dhe të vërteta.
2. Palët e interesuara mund të paraqesin prova për pasaktësinë e këtyre raporteve.
3. Nëse ka mospërputhje midis raporteve të zyrtarëve të ndeshjes të ndryshëm, dhe nuk ka mundësi për të zgjedhur midis fakteve të ndryshme, atëherë për incidentet e verifikuara brenda fushës së lojës do të merret në konsideratë raporti i arbitrit, ndërsa për incidentet e verifikuara jashtë fushës së lojës do të merret në konsideratë raporti i delegatit.

Neni 97 Barra e provës

1. FSHF ka barrën e provës për të gjitha shkeljet disiplinore të rregulloreve të saj.
2. Në rastin e shkeljes së rregullave anti-doping, është detyrim i palës së dyshuar të sigurojë provat në mbrojtje të saj për të ulur ose anuluar vendimin.

NËNSEKSIONI 4.
Përfaqësimi dhe asistenca

Neni 98 Përfaqësimi

1. Palët mund të angazhojnë përfaqësim ligjor gjatë procedimeve pranë organeve juridike.
2. Nëse nuk kërkohet që palët të paraqiten personalisht ato mund të përfaqësohen.
3. Palët janë të lira të zgjedhin vetë përfaqësuesin e tyre ligjor.

NËNSEKSIONI 5.

Gjuha e përdorur gjatë procedimit

Neni 99 **Gjuha**

1. Gjuha e përdorur gjatë procedimit do të jetë gjuha shqipe.
2. Në raste të caktuara, organet juridike mund të shfrytëzojnë një përkthyes për shkak të rrethanave përkatëse.
3. Nëse vendimi merret ndaj një pale që nuk ka gjuhë të parë gjuhën shqipe, atëherë organi juridik ka detyrimin të kryejë përkthimin e vendimit përkatës. Pavarësisht sa më sipër, vendimi në gjuhën shqipe ka përparësi në zbatim.

NËNSEKSIONI 6.

Njoftimi i vendimeve

Neni 100 **Pala e interesuar**

1. Të gjitha palët e interesuara njoftohen për vendimin e marrë.
2. Nëse nuk është paraqitur ndonjë apelim ndaj një vendimi për shkelje të rregullave anti-doping të marrë nga Komisioni i Disiplinës, ose vendimet e marra nga Komisioni i Apelit për shkelje të rregullave anti-doping, do të njoftohen edhe pranë World Anti-Doping Agency (WADA).

Neni 101 **Forma**

1. Vendimet e njoftuara nëpërmjet faksit kanë efekt të njëjtë ligjor. Vendimet mund të njoftohen edhe me postë dhe kanë të njëjtin efekt ligjor.
2. Komunikimi i vendimeve apo njoftimeve me poste elektronike lejohet në rastet kur palët pranojnë se kanë marrë dijeni.

NËNSEKSIONI 7.
Të ndryshme

Neni 102 Gabimet

1. Organet juridike kanë të drejtë të korrigojnë ndonjë gabim në llogaritje apo të tjera në çdo kohë.

Neni 103 Kostot dhe shpenzimet

1. Kostot dhe shpenzimet do të paguhen nga pala humbëse.
2. Nëse nuk ka palë humbëse kostot dhe shpenzimet do të paguhen nga FSHF.
3. Nëse vlerësohet e drejtë, palët mund të ndajnë kostot dhe shpenzimet midis njëra-tjetrës.
4. Organi juridik që merr vendimin përkatës mund të vendosë mbi mënyrën e ndarjes së kostove dhe shpenzimeve midis palëve të përfshira. Vendimi i ndarjes së kostove dhe shpenzimeve në këtë rast nuk është i apelueshëm.

Neni 104 Zbatimi i vendimeve

1. Vendimet hyjnë në fuqi dhe janë të zbatueshme menjëherë pas njoftimit të tyre.

Neni 105 Procedimet e pabazuara

1. Procedimi mund të pushojë nëse:
 - a) palët bien dakord midis tyre;
 - b) një palë shpall falimentin;
 - c) konsiderohet i pabazuar në ndonjë normë rregulluese ose ligjore.

SEKSIONI 2.
Komisioni i Disiplinës

NËNSEKSIONI 1.
Fillimi i procedimit dhe hetimi

Neni 106 **Fillimi i procedimit**

1. Shkeljet disiplinore procedohen nga çdo anëtar i Komisionit të Disiplinës.
2. Çdo person ka të drejtë të raportojë sjellje ose shkelje që ai i konsideron në kundërshtim me rregulloret e FSHF-së, pranë organeve juridike. Ankesat ose raportet përkatëse duhet të paraqiten me shkrim.
3. Zyrtarët e ndeshjes janë të detyruar të raportojnë çdo shkelje që ata marrin dijeni.

Neni 107 **Hetimi**

1. Sekretaria nëpërmjet inspektorëve të disiplinës kryen hetimin paraprak të nevojshëm nën udhëzimet e kryetarit të organit juridik.

Neni 108 **Bashkëpunimi i palëve**

1. Palët janë të detyruara të bashkëpunojnë për verifikimin dhe përcaktimin e fakteve. Në veçanti, palët duhet t'i përgjigjen të gjitha kërkesave për informacion të organeve juridike.
2. Kur e gjykon të arsyeshme sekretaria mund të verifikojë vërtetësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura nga ndonjë palë.
3. Nëse palët nuk përgjigjen ndaj kërkesave të organeve juridike, edhe pas paralajmërimit për dënime, kryetari i

organit juridik ka të drejtë marrë vendim për dënimin e palës kundërvajtëse me gjobë me një vlerë prej 100,000 (njëqind mijë) Lekë.

4. Nëse palët dështojnë në bashkëpunim dhe nuk paraqesin faktet e kërkuara në kohën e duhur, atëherë organi juridik e merr vendimin mbështetur në faktet që kanë në dorë deri në atë moment.

NËNSEKSIONI 2.

Deklaratat me gojë, shqyrtimi, vendimi

Neni 109 Deklaratat me gojë, parimet

1. Si rregull i përgjithshëm nuk ka deklarata me gojë, dhe organi juridik mbështetet vetëm në deklaratat me shkrim për të marrë vendim.
2. Me kërkesë të njëres nga palët, organi juridik mund të thërresë një seancë dëgjimore, në të cilën duhet të marrin pjesë të gjitha palët e përfshira në procedim.
3. Deklaratat me gojë dëgjohen gjithmonë me dyer të mbyllura.

Neni 110 Deklaratat me gojë, procedurat

1. Kryetari vendos për radhën e dëgjimit të deklaratave me gojë.
2. Pas dëgjimit të fakteve, kryetari i jep të drejtën palës ndaj të cilës kryhet procedimi përkatës një mundësi përfundimtare për të folur.

Neni 111 Shqyrtimi

1. Komisioni i Disiplinës kryen shqyrtimin e çështjeve

- përkatëse vetëm me dyer të mbyllura.
2. Nëse është zhvilluar ndonjë seancë dëgjimore, menjëherë pas saj kryhet shqyrtimi përkatës.
 3. Shqyrtimi kryhet pa ndërprerje, përveç rasteve kur ka rrethana të veçanta.
 4. Kryetari vendos për radhën e çështjeve që shqyrtohen.
 5. Anëtarët e pranishëm shprehin opinionet e tyre sipas radhës së caktuar nga kryetari, i cili gjithmonë flet i fundit.
 6. Sekretari i komisionit kryen vetëm funksione të konsulencës.

Neni 112 Marrja e vendimit

1. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e pranishëm.
2. Çdo anëtar i pranishëm duhet të votojë.
3. Nëse votimi del i barabartë, atëherë vota e kryetarit është vendim-marrëse.

Neni 113 Forma dhe përmbajtja e vendimit

1. Pavarësisht zbatimit të Nenit 114 këtu më poshtë, vendimi duhet të përmbajë:
 - a) përbërjen e komisionit;
 - b) emërtimet e palëve;
 - c) një përmbledhje të fakteve;
 - d) argumentimin e vendimit;
 - e) bazën ligjore mbi të cilën mbështetet vendimi i marrë;
 - f) dispozitivin e vendimit;
 - g) afatin kohor dhe organin ku mund të bëhet apelimi i vendimit.
2. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari i komisionit.

Neni 114 Vendimet pa argumentim

1. Organet juridike mund të vendosin që të mos komunikojnë argumentimin e vendimeve të marra por të komunikojnë vetëm kushtet e vendimit përkatës. Ndërkohë palët do të njoftohen se kanë një afat prej 10 (dhjetë) ditësh që të kërkojnë me shkrim argumentimin e plotë të vendimit përkatës, dhe mos ushtrimi i kësaj të drejte do të rezultojë në hyrjen në fuqi të vendimit siç është marrë.
2. Nëse njëra nga palët kërkon argumentimin e vendimit, atëherë vendimi i plotë bashkë me argumentimin do t'i komunikohet me shkrim palëve të interesuara. Në këtë rast, afati për apelimin e vendimit fillon në momentin e marrjes së vendimit të plotë bashkë me argumentimin përkatës.
3. Nëse palët nuk kërkojnë argumentimin e vendimit atëherë, vendimi përkatës do të arkivohet vetëm me një përshkrim të shkurtër të argumentimit.

SEKSIONI 3.
Komisioni i Apelit

Neni 115 Vendimet e apelueshme

1. Në Komisionin e Apelit mund të apelohej kundër çdo vendimi të marrë nga Komisioni i Disiplinës, përveç rasteve kur dënimi i vendosur është:
 - a) një paralajmërim;
 - b) qortim;
 - c) një pezullim nga ndeshjet për më pak se 4 (katër) ndeshje, ose më pak se 3 (tre) muaj;
 - d) një gjobë me vlerë më të ulët se 100,000 (njëqind mijë) Lekë ndaj personave juridikë, shoqatave, ose klubeve dhe 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë për lojtarët, trajnerët

ose zyrtarët e klubeve;
e) vendim i marrë në përputhje me Nenin 63 të këtij kodi.

Neni 116 E drejta për të apeluar

1. Kushdo që ka qenë palë gjatë procedimit në marrjen e një vendimi në nivelin e parë të gjykimit, dhe ka interesa ligjore për anulimin ose ndryshimin e vendimit përkatës mund të apelojë pranë Komisionit të Apelit.
2. Personat juridikë, shoqatat ose klubet mund të apelojnë kundër vendimeve të marra ndaj lojtarëve ose zyrtarëve të tyre.

Neni 117 Afati i apelimt

1. Çdo palë që kërkon të apelojë duhet të njoftojë Komisionin e Apelit brenda 3 (tre) ditëve nga momenti i marrjes së njoftimit për vendimin përkatës.
2. Arsyet e apelimt duhet të paraqiten me shkrim brenda 7 (shtatë) ditëve nga skadimi i afatit prej 3 (tre) ditësh, të kërkesës për apelim.
3. Nëse arsyet e apelimt nuk paraqiten me shkrim atëherë apelimt nuk pranohet.

Neni 118 Argumentimi i apelimt

1. Apeluesi mund të kundërshtojë mbi pasaktësinë e vlerësimit të fakteve, ose zbatimin e gabuar të ligjit ose rregulloreve.

Neni 119 Kërkesa e apelit

1. Apeluesi duhet të paraqesë kërkesën e tij të apelit në tre kopje.
2. Kërkesa duhet të përmbajë pretendimin si dhe arsyet dhe

provat e mundshme, dhe duhet të nënshkruhet nga pala e interesuar ose nga përfaqësuesi ligjor përkatës në përputhje me Nenin 118 të këtij kodi.

Neni 120 Kostot

1. Kushdo që kërkon të paraqesë një apelim duhet të paguajë një tarifë apelimi në llogarinë bankare të FSHF-së përpara skadimit të afatit prej 7 (shtatë) ditësh për të formalizuar apelimin. Kur kërkesa për apel bëhet nga personi juridik, shoqata apo klubi i interesuar pagesa është 100,000 (njëqind mijë) Lekë. Kur kërkesa për apel bëhet nga një lojtar apo zyrtar pagesa është 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë.
2. Nëse nuk kryhet pagesa përkatëse si më sipër, kërkesa e apelimit nuk pranohet.
3. Shuma më sipër do të rimbursohet nëse apeluesi e fiton çështjen përkatëse. Nëse apeluesi e humb çështjen përkatëse, atëherë tarifa e apelimit nuk rimbursohet.
4. Nëse apelimi vlerësohet i pabazë, atëherë tarifa e apelimit nuk rimbursohet.

Neni 121 Efektet e apelimit

1. Apelimi rezulton në çdo çështje që shqyrtohet nga Komisioni i Apelit.
2. Apelimi nuk ka efekte të pezullimit të zbatimit të ndonjë vendimi përveç rasteve të sanksioneve me gjobë ose urdhrave për të paguar ndonjë shumë parash.

Neni 122 Radha e procedimit

1. Radha e procedimit përcaktohet siç përsihkruhet në këtë kod.
2. Vendimet nënshkruhen nga kryetari dhe sekretari.

3. Vendimet nuk mund të hamendohen në dëm të palës që i kundërshton ato.

Neni 123 Vazhdimi i procedimit

1. Si rregull, Komisioni i Apelit merr vendimet si niveli i fundit i gjykimit.

SEKSIONI 4.
Arbitrazhi

Neni 124 Arbitrazhi

1. Vendime të organeve të disiplinës që nuk mund të apelojnë tek Gjykata e Arbitrazhit për Sportet (CAS) janë vetëm ato që mund të përcaktohen si të tilla në Statutin e FSHF.

SEKSIONI 5.
Procedurat e veçanta

Nënsesioni 1.
Masat e përkohshme

Neni 125 Rregulli i përgjithshëm

1. Nëse një shkelje është kryer dhe është e pamundur për të marrë një vendim në kohën e duhur, në emergjencë, kryetari i organit juridik mund të shpallë, modifikojë ose anullojë një dënim në mënyrë të përkohshme.
2. Në të njëjtën mënyrë, si më sipër, kryetari i organit juridik

- mund të marrë masa të tjera të përkohshme.
3. Ai vepron me kërkesë të palës së interesuar ose me vullnetin e tij.

Neni 126 Procedura

1. Kryetari i organit juridik i merr vendimet duke u mbështetur mbi faktet që ka në dispozicion në atë moment.
2. Ai nuk është i detyruar të dëgjojë palët e interesuara.

Neni 127 Vendimi

1. Kryetari i organit juridik i shpall vendimet menjëherë.
2. Vendimet mund të zbatohen menjëherë, në rastin e dënimeve me pezullim nga ndeshja.

Neni 128 Kohëzgjatja

1. Masat e përkohshme nuk mund të jenë të vlefshme pas një periudhe prej 30 (tridhjetë) ditësh nga momenti i marrjes së vendimit përkatës.
2. Kjo periudhë mund të shtyhet vetëm njëherë për jo më shumë se 20 (njëzet) ditë.
3. Nëse ndonjë dënim me pezullim është marrë si masë e përkohshme, atëherë pas marrjes së vendimit përfundimtar periudha e pezullimit do të kompensohet përkatësisht.

Neni 129 Apelimi

1. Apelimi kundër një vendimi për masa të përkohshme mund të depozitohet pranë kryetarit të Komisionit të Apelit.
2. Afati për depozitim të apelimit është brenda 2 (dy) ditësh nga njoftimi i vendimit përkatës.

3. Kërkesa e apelimit mund të dërgohet menjëherë nëpërmjet faksit pranë FSHF-së, brenda të njëjtit afat si më sipër.
4. Apelimi nuk ka efekte pezulluese mbi vendimet e marra.

Neni 130 Miratimi i apelimit

1. Apelimi do të pranohet nëse faktet e përmbajtura në vendimin e kundërshtuar janë të pasakta ose nëse është shkelur ligji.

NËNSEKSIONI 2.
Shtrirja e efektit të dënimeve

Neni 131 Kërkesa

1. Nëse verifikohet një shkelje e rëndë, në veçanti por jo duke u kufizuar, për doping, trukim të rezultatit të ndeshjes, cënim të zyrtarëve të ndeshjes, mashtrim dhe fallsifikim, organet juridike të FSHF-së do të kërkojnë pranë FIFA-s shtrirjen e efekteve të dënimeve të vendosura në shkallë botërore.
2. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të përmbajë një kopje të noterizuar të vendimit ku është vendosur dënimi përkatës. Kërkesa duhet të paraqesë emrin dhe adresën e personit të dënuar si dhe emërtimin e klubit përkatës.

Neni 132 Kushtet

1. Një kërkesë për shtrirjen e efekteve të dënimeve të vendosura do të dërgohet pranë FIFA-s vetëm nëse janë përmbushur kushtet si më poshtë:
 - a) personi i dënuar është emërtuar në mënyrë të saktë;

- b) personi i dënuar ka patur mundësinë të shprehet në lidhje me çështjen;
- c) vendimi i marrë është komunikuar siç duhet;
- d) vendimi i marrë përputhet me rregulloret e FIFA-s;
- e) shtrirja e efekteve të dënimit të vendosur nuk bie ndesh me interesin publik.

SEKSIONI 6.
Rishikimi

Neni 133 Rishikimi i vendimeve

1. Pas marrjes dhe hyrjes në fuqi të një vendimi përfundimtar, nëse një palë zbulon fakte ose prova të cilat do të rezultojnë në marrjen e një vendimi më të favorshëm, kjo palë ka të drejtë të kërkojë rishikimin e vendimit përkatës.
2. Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i zbulimit të arsyeve për rishikim.
3. Periudha e parashkrimit për të paraqitur një kërkesë për rishikim të vendimit është 1 (një) vit pas hyrjes në fuqi të vendimit përkatës.

TITULLI IV DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 134 Qëllimi i kodit, mangësitë, dhe precedentët

1. Ky kod është i zbatueshëm nga çdo subjekt që përkruhet në përcaktimet e këtij kodi.
2. Nëse ka ndonjë mangësi në këtë kod, organet juridike do të marrin vendimet në përputhje me precedentët e krijuar më parë, dhe në mungesë të precedentëve, në përputhje me rregullat që ata mund të formulonin për çështjen në fjalë sikur të ishin legjislatorë.

Neni 135 Konvertimi i dënimeve

1. Dënimet në vijim:
 - (i) pezullim nga ndeshja;
 - (ii) zhvillim i ndeshjes pa spektatorë; dhe
 - (iii) zhvillim i ndeshjes në fushë asnjënjë; mund të konvertohen në dënime me gjobë.
2. Pezullimi nga ndeshja i lojtarëve ose zyrtarëve për më shumë se 1 (një) ndeshje mund të konvertohet pasi të jetë shlyer gjysma e dënimit.
3. Dënimet e përcaktuara këtu më sipër në paragrafin 1 të këtij neni konvertohen si më poshtë:
 - a) zhvillimi i ndeshjes pa spektatorë do të konvertohet me gjobë me vlerë prej 500,000 (pesëqind mijë) Lekë, për çdo ndeshje vetëm pasi të jetë kryer gjysma e dënimit;

- b) zhvillimi i ndeshjes në fushë asnjëherë do të konvertohet me gjobë me vlerë prej 600,000 (gjashtëqind mijë) Lekë, për çdo ndeshje vetëm pasi të jetë kryer gjysma e dënimit;
 - c) pezullimi nga ndeshja i lojtarëve ose zyrtarëve do të konvertohet me gjobë pasi të jetë kryer gjysma e dënimit si në vijim :
 - (i) Pas kryerjes së gjysmës së dënimit të pezullimit, dënimi mund të konvertohet me gjobë me vlerë prej 100,000 lekë për çdo ndeshje.
4. Konvertimi i dënimeve do të kryhet për të gjitha ndeshjet e mbetura nga dënimi në përputhje me përcaktimet e pikës 3 të këtij neni. Nuk mund të konvertohen dënimet me mbi 10 ndeshje pezullim nga aktiviteti, dënimet e dhëna mbi shkeljet e Statusit të Lojtarit apo dënimet e dhëna nga Komisioni i Etikës.
5. Kur lojtari ose zyrtari i cili aktivizohet në një ndeshje duke zbatuar përcaktimet në këtë nen, dënimet gjatë zhvillimit të ndeshjes përkatëse, dënimet e marra do t'i mblidhen dënimeve ekzistuese.

Neni 136 Reduktimi i dënimeve me gjobë

1. Për Veprimtaritë futbolistike të niveleve më të ulëta se Kampionati Kombëtar i Kategorisë Superiore dënimet me gjoba të aplikohen në masën si më poshtë:
- a) Për Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Parë: 50 %
 - b) Për Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Dytë: 20 %
 - c) Për Kampionatin Kombëtar të Kategorisë së Tretë: 10 %
 - d) Për veprimtaritë e futbollit të femrave: 5 %
 - e) Për veprimtaritë e futbollit për të rinj: 3 %
 - f) Për veprimtaritë e futbollit 5x5: 20 %

Neni 137 Zbatimi i kodit

1. Ekzekutimi I Vendimeve
Vendimet e organeve juridike të FSHF, të cilat përmbajnë detyrime në të holla janë të detyrueshme për t'u ekzekutuar.
Nëse vendimi i trupës gjyquese nuk është ekzekutuar vullnetarisht nga debitori, dhe ky I fundit ka kredi pranë FSHF, ai ekzekutohet nga kjo kredi, nga Sekretariati Teknik me kërkesë të kreditorit.
Sekretariati Teknik, pasi njofton debitorin, urdhëron Departamentin e Financave të vërë sekuestro mbi kredinë e debitorit dhe ta kalojë atë në favor të kreditorit.
FSHF konsiderohet gjithmonë si kreditor që merr pjesë bashkë me kreditorët e tjerë për detyrimin që po ai debitor i ka FSHF-së si rrjedhojë e kuotave të papaguara të pjesëmarrjes, anëtarësimit apo detyrime të tjera.
Detyrimet e vendosura me vendim te organeve te drejtësisë sportive, paguhen me preferim në këtë radhë:

- * Kreditë që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës apo shërbimit për te lojtarët/trajnerët ne klube;
- * Kreditë që rrjedhin nga dënimet disiplinore të dhëna kundër klubeve.
- * Detyrimet për anëtarësim apo kuota te papaguara.

Kur shuma e nxjerrë nga ekzekutimi nuk mjafton për të paguar të gjithë kreditorët, Sekretariati Teknik në bashkëpunim me Sektorin e Financës, përgatit një projekt ndarje, duke veçuar fillimisht shumat për kreditë që paguhen me preferim dhe nga pjesa tjetër, që mbetet, paguan kreditë e tjera.

Tiranë, 15 mars 2017.

Për Komitetin Ekzekutiv të FSHF-së
Armand Duka
President

Ilir Shulku
Sekretar i Përgjithshëm

Botim zyrtar 2017